



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 2 DHE TË ZAZ-SË NR. 3, QARKU SHKODËR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 27.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 2 dhe ZAZ-së nr. 3, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet:

nr.259 datë 08.05.2019, ka miratuar caktimin e VNV së KZAZ nr. 2 në Pallatin e Sportit "Qazim Dervishi", me sipërfaqe mbi 650 m², Bashkia Shkodër;

nr.260, datë 14.05.2019, ka miratuar caktimin e VNV së KZAZ nr.3, në Shkollën "Shejnaze Juka", palestra me sipërfaqe 200 m².

Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën drejtuar KQZ nr.12491, datë 27.06.2019, bazuar në përcaktimet e ligjit 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", në ushtrim të përgjegjësisë në situatën e krijuar, referuar shkresave të Kryetarit të Bashkisë Shkodër për lirimin e ambienteve në përgjegjësi administrimi të Bashkisë, si dhe shqetësimit të përcjellë nga KZAZ nr.2 dhe KZAZ nr.3, propozon ndryshimin e vendndodhjeve të:

VNV-së së ZAZ nr. 2, nga Pallati i Sportit "Qazim Dervishi", në Shkollën "Arben Broci", Palestra nr.2, me sipërfaqe 400 m², Bashkia Shkodër;

VNV-së së ZAZ nr. 3, nga Shkollën "Shejnaze Juka", në Shkollën "Arben Broci", palestra nr.1, me sipërfaqe 150 m², Bashkia Shkodër;



Nr. 904 i Vendimit Data 27.06.2019 e Vendimit Ora 18.00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të ZAZ-ve nr. 85 dhe ZAZ-së nr 87, Qarku Vlorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

Kryetarja e Bashkisë Shkodër, i ka bërë publike kërkesat për lirim të ambienteve në përgjegjësi administrimi, ambiente ku adminstrata zgjedhore, KZAZ-të nr. 2 dhe nr. 3, ushtrojnë funksionet e tyre publike për përgatitjen e procesit zgjedhor të datës 30.06.2019, dhe gjithashtu këto kërkesa e kanë adresuar shkresërisht edhe në KQZ (shkresa nr. 11957 prot., datë 20.06.2019).

Kërkesa dhe objektet e propozuara nga Prefekti i Qarkut Shkodër, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, kriteret e Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, për caktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 2, në Shkollën "Arben Broci", Palestra nr.2, me sipërfaqe 400 m2, Bashkia Shkodër.
2. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr.3, në Shkollën "Arben Broci", palestra nr.1, me sipërfaqe 150 m2, Bashkia Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement ZGURI Kryetar

Denar BIBA Zëvendëskryetar

Bledar SKËNDERI Anëtar

Edlira JORGAQI Anëtare

Rezarta BITRI Anëtare



Nr. 904 i Vendimit Data 27.06.2019 e Vendimit Ora 18.00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të ZAZ-ve nr. 85 dhe ZAZ-së nr 87, Qarku Vlorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019